



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Studime Britanike 1

Ngarkesa: 4 kredite (40 orë), (20 orë leksione, 20 orë seminare)

Viti / Semestri: Viti III, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Gjuhë Angleze, “Studime Britanike dhe Amerikane “

Kodi i Etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9):

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithsme lëndore : Të pajisë studentët me njohuri themelore dhe të avancuara mbi institucionet dhe kulturën britanike bashkëkohore. Të nxisë të kuptuarit e marrëdhënieve ndërkombëtare të Britanisë së Madhe dhe të kontekstit të saj politik e shoqëror. Të aftësojë studentët për të analizuar dhe interpretuar në mënyrë kritike tekstet bashkëkohore në lidhje me sfondin kulturor, politik dhe shoqëror britanik.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të njohë studentët me konceptet kyçe të monarkisë kushtetuese, sistemit parlamentar dhe kornizës politike të Mbretërisë së Bashkuar.
2. Të zhvillojë aftësinë e studentëve për të eksploruar në mënyrë analitike tekstet që trajtojnë aspekte të kulturës, historisë dhe politikës britanike.
3. Të udhëheqë studentët drejt zhvillimit të një qëndrimi të argumentuar dhe artikulimit të mendimit kritik për çështje kulturore dhe shoqërore.

Rezultatet e pritshme:

Në përfundim të kësaj lënde studentët do të jenë të aftë:

1. Të analizojnë marrëdhëniet ndërmjet Kulturës Bashkëkohore britanike dhe historisë politike, shoqërore dhe kulturore;
2. Të diskutojnë për mënyrat në lidhje me organizimin e shoqërisë dhe natyrës së identitetit;
3. Të identifikojnë dhe të përshkruajnë karakteristika të veçanta kulturore dhe artistike të kulturës bashkëkohore britanike;
4. Të analizojnë tekste konkrete në lidhje me kuptimin e tyre, duke i vendosur ato në kontekstin e duhur historik dhe kulturor dhe duke përdorur terminologjinë e duhur;